



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3313/prot.  
2

Himarë, më 20.06.2024

**NJOFTIM**

**Lënda :** Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Himarë.

Të nderuar këshilltarë!

Ju njoftoj se ditën e mërkurë ora 10:30 në sallë e stadiumit "Petro Ruci" Himarë do të zhvillohet mbledhja e radhës për muajin qershor, e Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të pikës 4, neni 53, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar. Mbledhja do të ketë rend dite.

I. Miratimi i rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për ngritjen e këshillit kulturor dhe artistik pranë Bashkisë Himarë".
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për krijimin e komisioneve të përkohshme me kryetarët e fshatrave të Bashkisë Himarë".
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e ndryshimeve buxhetore qershor 2024".
4. Ndryshimet buxhetore qershor 2024
5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e planit të veprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave në Bashkinë Himarë".
6. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Shtesë për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e suksesshëm të sezonit turistik 2024 dhe planit të veprimit përkatës".
7. Shqyrtimi i projektvendimit "Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1 – 30 prill 2024, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok – ndihmës ekonomike".
8. Shqyrtimi i projektvendimit "Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1 – 31 maj 2024, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok – ndihmës ekonomike".

Sekretar  
Elena Memushaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA HIMARË  
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr. 3313 prot.

Himarë, më 20.06. 2024

VENDIM

Nr. 6 datë 18.06. 2024

PËR MIRATIMIN E NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 17,56 dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB, Nr. 33 datë 28.07.2023 neni 27. Kryesia e këshillit në mbledhjen e datës 18.06. 2024

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e Këshillit Bashkiak e cila do të mbahet më datë 26.06. 2024.
2. Ngarkohet sekretari këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet sekretari këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës si dhe materialet relevante të mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari Bashkisë, deputetët e qarkut, tek personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltarë dhe tek kryetari Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Sekretar i Këshillit Bashkiak



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr 3313/prot.  
11

Himarë, 20.06.2024

## NJOFTIM

**Lënda :** Njoftim për mbledhjen e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak Himarë

**Drejtuar:** Anëtarëve të komisioneve të përhershme.

**Drejtoria e financës , planifikimit të buxhetit dhe integrimin evropian.**

**Drejtoria e shërbimeve publike dhe mbështetëse.**

Ju njoftojmë se mbledhjet e komisioneve të përhershme për shqyrtimin e projektvendimeve do të zhvillohen në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë si më poshtë :

**1.Komisioni ekonomisë, financës dhe auditit datë: 24.06.2024 ,ora 10:00**

**Shqyrtimi i projektvendimit "Shqyrtimi i projektvendimit " Për ndryshimet buxhetore qershor 2024.**

**Anëtarë komisioni:**

- 1.Gjergj Iliadhi.
- 2.Miltiadh Prifti.
- 3.Silva Burbo.
- 4.Loreta Isufi.
5. Maks Vlasi.

**2.Komisioni i zhvillimit urban , infrastrukturës dhe shërbimeve mbështetëse datë 24.06.2024 , ora 11:00**

**Shqyrtimi i projektvendimit " Për miratimin e planit të veprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave në Bashkinë Himarë**

Spile ,Himare , tel. : 039322355, fax 039322533 ,[www.himara.gov.al](http://www.himara.gov.al) e-mail:[bashkiahimare@yahoo.com](mailto:bashkiahimare@yahoo.com)

Shqyrtimi i projektvendimit “ Shtesë për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e suksesshëm te sezonit turistik 2024 dhe planit të veprimit përkatës”.

Anëtarë komisioni .

1. Timoleo Gërdhuqi
2. Qirjako Mërkuri
3. Artionil Shirokaj
4. Afrovita Dhimojani
5. Aleks Llazari
6. Artan Bala
7. Gjergji Iliadhi

SEKRETARI

Elena Memushaj

